



Buletini i muajit Prill 2025

Buletini i muajit Prill 2025

30.04.2025

Çështjet kryesore:

- Dëgjesa publike për Planin Vendor të Veprimit për Efiçencën e Energjisë.
- Mbledhja e Këshillit Bashkiak Mirditë për muajin Prill.
- “Eja n' Mirditë.
- Bashkia Mirditë marrëveshje bashkëpunimi me Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë dhe ILO.
- Restaurimi i monumentit të 42 viktimave të regjimit komunist.
- Rrëshen – zhvillohet mbledhja e parë me administratorët e pallateve.
- Ekipi i Volejbollit.

Bashkia Mirditë marrëveshje bashkëpunimi me Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë.

Më datë 7 prill 2025, mirëpritëm në një takim zyrtar në Bashkinë Mirditë përfaqësues të lartë të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), Federatës së Sindikatave të Administratës Publike dhe Shërbimit Civil (FSAPSHCSH), si dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Pjesëmarrës në këtë takim ishin Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Mirditë z. Artur Lazri, Z. Kol Nikollaj, President i KSSH, Znj. Anisa Subashi, Zëvendës Presidente e KSSH-së dhe Sekretare e Përgjithshme e Federatës së Sindikatave të Administratës Publike dhe Shërbimit Civil të Shqipërisë - FSAPSHCSH, ndërmjet të cilave FSAPSHCSH dhe Bashkisë Mirditë ka kontratë Kolektive Pune, Agustin Gjikola, Kryetar i KSSH për Mirditën, si dhe Znj. Zhuljeta Harasani, Koordinatorja Rajonale e ILO për Shqipërinë dhe Prof. Dr. Arta Mandro Eksperte e Lartë e ILO-s .

Në kuadër të këtij takimi u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit që synon përmirësimin e standardeve të punës në administratën publike vendore.

Kryetari i Bashkisë, z. Melyshi, në fjalën e tij shprehu gatishmërinë dhe mbështetjen e plotë për këtë shërbim të ofruar nga KSSH / FSAPSHCSH në funksion të demokratizimit të mëtejshëm të funksionimit të brendshëm të Bashkisë, për një mjedis pune të qetë, miqësor, etik dhe profesional, për ngritjen e një grupi pune mbi çështjen që mbulon C 190, por gjithashtu edhe për të gjitha çështjet që do të adresohen nga Sindikata në mbrojtje të interesave të punonjësve të Bashkisë Mirditë.

Takimi u pasua me një trajnim tematik për stafin e Bashkisë Mirditë, i cili kishte në fokus ndërgjegjësimin dhe aftësimin e punonjësve për të identifikuar dhe adresuar situata që lidhen me shkeljen e të drejtave në vendin e punës, si dhe forcimin e mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e tyre.



Eja n’Mirditë” – Nxënësit e shkollës “Nënë Tereza” promovojnë turizmin dhe trashëgiminë vendase.

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Nënë Tereza” në Rrëshen po zbatojnë projektin ndërlëndor “Eja n’Mirditë”, një nismë edukative që synon të ndërgjegjësojë brezin e ri për bukuritë, kulturën dhe trashëgiminë e vendlindjes së tyre.

Me moton “Turizmi fillon nga vendlindja”, projekti i kthen nxënësit në eksplorues dhe ambasadorë të parë të turizmit lokal.

Përmes aktiviteteve kërkimore, kreative dhe bashkëpunimesh komunitare, nxënësit kanë krijuar tre produkte konkrete që ndërthurin edukimin qytetar me artin dhe teknologjinë:

1. Ekspozita Turistike – “Mirdita në hartë”


Prezanton atraksionet kryesore turistike të vizituara ndër vite nga nxënësit, të shoqëruara me një hartë të punuar në kanavacë, fotografi autentike nga terreni dhe kartolina simbolike që ftojnë komunitetin dhe vizitorët të zbulojnë thesaret e Mirditës. Ky produkt shërben si një mjet ndërgjegjësuës për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

2. Ekspozita “Rrësheni dje dhe sot”

Një paraqitje vizuale e evolucionit të qytetit përmes fotografive historike, dokumenteve dhe materialeve që krahasojnë të shkuarën me të tashmen. Ekspozita ngjall reflektim mbi identitetin urban dhe kujtesën kolektive.

3. Dokumentari “Rrësheni ynë”

Një rrëfim filmik i përgatitur nga vetë nxënësit, që mbledh intervista me qytetarë, histori personale dhe dëshmi mbi transformimin dhe jetën e përditshme në qytet ndër vite.



Plani Vendor i Veprimit për Eficiencën e Energjisë.

Më datë 16 Prill 2025, në Rrëshen u zhvillua dëgjesa publike për Planin Vendor të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, si pjesë e zbatimit të projektit “EFFORT”.

Gjatë këtij takimi u prezantuan masat konkrete që synojnë përmirësimin e eficiencës energjetike të ndërtesave publike në territorin e Bashkisë Mirditë.

Projekti synon të zhvillojë praktikrat e qëndrueshme të përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë në Mirditë, zvogëlimin të konsumit të energjisë, menaxhimit të ndërtesave, apo edhe rinovimit të ndërtesave me efikasitet energjetik.

Ky projekt zbatohet në bashkëpunim nga Bashkia Mirditë, Komuna Junik dhe organizata Co-PLAN, dhe financohet nga Bashkimi European në kuadër të programit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar Shqipëri–Kosovë.



Mbledhja e Këshillit Bashkiak Mirditë për muajin Prill 2025.

Më datë 25 Prill 2025, u zhvillua mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Mirditë ku u miratuan projekt-vendimet e mëposhtme:

P/Vendim nr. 1532/1 prot, “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kush-tëzuar, për bllok-ndihmën deri në 6%, për periudhën 01 - 31 Mars 2025”,

P/Vendim nr. 1581/1 prot, “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për bllok-ndihmën me fondine bashkisë, për periudhën 01 - 31 Mars 2025”.

P/ Vendim nr. 1421/2 prot, “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.

P/ Vendim nr. 1567/1 prot, “Për miratimin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjar-rit në banesën e z. G.C., fshati Tharri, njësia administrative Kthellë, bashkia Mirditë dhe përdorim fondi mbrojtjes civile”.

P/ Vendim nr. 1568/1 prot, “Për miratimin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjar-rit në banesën e znj. D.R., fshati Kulme, njësia administrative Kthellë, bashkia Mirditë dhe përdorim fondi mbrojtjes civile”

P/ Vendim nr. 1594 prot, “Për një ndryshim (korigjim)”, në Vendimin nr. 7, datë 24.01.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë, “Për miratimin e pagesës së qirasë për një periudhë 1 (një) vjeçare, sipas vlerës së tregut, për familjet e pastrehë”.



Rrëshen – Zhvillohet mbledhja e parë me administratorët e pallateve.

Në ambientet e Bashkisë Mirditë është zhvilluar mbledhja e parë informuese me administratorët e pallateve të qytetit të Rrëshenit, në prani të Kryetarit të Bashkisë, z. Albert Mëlyshi, dhe Administratorit të Njësisë Administrative Rrëshen, z. Gjin Mandreja.

Takimi kishte në fokus diskutimin e detyrave dhe përgjegjësi të administratorëve, të cilat përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 16.06.2010.

Detyrat kryesore të administratorëve përfshijnë:

- Sigurimin për mirëmbajtjen dhe pastrimin e ambienteve të përbashkëta (shkallë, korridore, oborre).
- Sigurimin e funksionimit të sistemeve teknike në pallat (ndriçimi, kanalizimet, ashensorët – kur ka).
- Mbajtjen e rregullit dhe sigurisë në godinë, duke përfshirë edhe masat kundër zjarrit.
- Njoftimin dhe ndërveprimin me bashkëpronarët për çdo çështje që lidhet me mirëadministrimin;
- Raportimin pranë Bashkisë në rastet kur hasen problematika që kërkojnë ndërhyrje institucionale.

Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt formalizimit dhe përmirësimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.



Restaurimi i monumentit të 42 viktimave të regjimit komunist.

Si pjesë e angazhimit të Bashkisë Mirditë për të ruajtur dhe promovuar vlerat historike e kulturore të Mirditës, si dhe për të forcuar kujtesën kolektive nëpërmjet veprave konkrete është rikonstruktuar monumenti i 42 viktimave të regjimit komunist i vendosur pranë Muzeut Historik të Mirditës në Rrëshen.



Mirdita - Volejboll

Ekipi U-20 i Mirditës mbyll kampionatin e volejbollit në vendin e katërt.

Pas një sezoni të angazhuar dhe plot përkushtim, ekipi U-20 i Mirditës ka përfunduar rugëtimin e tij në kampionatin kombëtar të volejbollit duke u renditur në vendin e katërt në renditjen përfundimtare.

Ky rezultat është dëshmi e punës së palodhur të trajnereve, përkushtimit të lojtareve të reja dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Mirënjohje për të gjithë ata që kontribuan në këtë arritje.

